



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 6611 prot.

Elbasan, më 11.8.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr.63 dt.29.07.2025 “Për miratimin e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve në Bshkinë Librazhd”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Ilir BEJTJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5207 prot

VENDIM

Datë.31.07.2025

Nr.63 dt.29.07.2025

**"PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT
TË MBETJEVE NË BASHKINË LIBRAZHD"**

Këshilli i Bashkisë Librazhd, bazuar në Ligjin nr. 10463, datë 22/09/2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", neni 12 dhe neni 13, Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 10431/2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", i ndryshuar, Ligjin nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Ligjin nr.8094, datë 21.03.1996, "Për largimin publik të mbeturinave", VKM nr. 418/2020, "Për Miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035", VKM nr. 671/2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", në funksion dhe në përmbushje të kuadrit ligjor mjedisor, VKM nr.418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", VKM nr.608, datë 17.09.2014, "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre", VKM nr.319, datë 31.05.2018, "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve", VKM nr. 402 datë 30.06.2021 "Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve", VKM nr. 957 datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike", VKM nr. 452, datë 11.07.2012, ndryshuar me VKM nr. 389, datë 27.6.2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452, datë 11.07.2012 të Këshillit të Ministrave", VKM nr. 575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" në mbledhjen e datës 29.07.2025.

V E N D O S I:

1. Të miratojë Planin Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane të Bashkisë Librazhd për vitet 2025- 2029;
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit Menaxhimit Financiar dhe Shërbimit Social, Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Pronës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e të Ardhurave Vendore ;
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 55, pika 6 .

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

ZV/KRYETAR I KËSHILLIT
Silyana HOXHA

